



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOCATES BAR ASSOCIATION  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA

V.KA.nr.6-4/2020

**KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga Ruzhdi Berisha – kryetar i kolegjit, Daut Rudi dhe Edona Sina, anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Vjollca Ajeti, Administratore në Zyren Disiplinore të OAK-së, duke vendosur sipas ankesës Nr. 5-6/2022 dt. 18.05.2022 të ushtruar nga e paraqitura av. Merita Bajraktari, nga Prishtina, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të OAK-së V.KD. nr.5-5/2022 të datës 22.04.2022, në seancën jo publike të mbajtur me datën **07.06.2022** mori këtë:

#### V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e ushtruar nga e paraqitura av. [redacted] nga Prishtina nr.5-6/2022 e datës 18.05.2022, ashtu që **ANULOHET** vendimi i Komisionit Disiplinor i OAK-së V.KD, nr. 5-5/2022 dt. 22.04.2022.

II. Lirohet nga përgjegjësia disiplinore e paraqitura av [redacted], nga Prishtina.

III. Shpenzimet procedurale bijën në ngarkesë të buxhetit të OAK-së.

#### Arsyetimi

Komisioni Disiplinor i OAK-së, me vendimin V.KD.Nr.5-5/2022 të datës 22.04.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor disiplinor me 22.04.2022, av. [redacted], me seli të zyrës në Prishtinë, e ka shpallur përgjegjëse për shkak se në përgjigjen në ankesë të dorëzuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës, më 08.07.2020, në çështjen kontestimore me shenja të shkresave C, nr. 3611/2017, ka përdorë fjalët: “. . . *Aktvendimi ndaj të paditurës [redacted] nga [redacted] mund të jetë i dyshimtë ashtu siç ka ndodhur të jetë i rrem edhe bllokimi i mjeteve të xhirollogarisë në emër të [redacted]*” dhe “. . . *kurse ne jemi duke vazhduar procedurat gjyqësore fiktive*”. Konsideron se me këtë ka bërë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokates nga neni 118 par. 1 pika 1.3 të Statutit të OAK-së lidhur me nenin 5, 6, 37, dhe 38 të Kodit të Etikës Profesionale për Avokat.



Për shkak të shkeljes së rëndë të bërë si më sipër, av. \_\_\_\_\_, nga Prishtina, i është shqiptuar masa disiplinore e vërejtjes dhe është detyruar në emër të paushallit disiplinor të paguaj 50,00 € brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Kundër këtij vendimi e paraqitura av. \_\_\_\_\_, ka paraqitur ankesë duke e konsideruar atë si jo të drejtë dhe të kundërligjshëm, përpos tjerash edhe nga arsyeja se në çështjen kontestimore për të cilën është zhvilluar kjo procedurë ajo ka qenë palë ndërgjyqëse - paditëse, nga edhe nuk ka mundur në atë cilësi të bënë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokates dhe të shpallet përgjegjëse si në dispozitivin e vendimit të Komisionit Disiplinor të kundërshtuar.

Komisioni i Ankesave i OAK-së, si organ i shkallës së dytë, pas vlerësimit të gjitha pretendimeve në ankesën e paraqitur, provave dhe shkresave tjera të lëndës, në mbështetje të nenit 110 par.1 dhe par.2 të Statutit të OAK-së, si dhe nenit 46 par.1 pika 1.2, 49, 52 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, ka gjetur se:

Ankesa e të paraqiturës, av. \_\_\_\_\_, nga Prishtina. është e bazuar.

Me aktvendimin e kundërshtuar me ankesë të Komisionit Disiplinor të OAK-së V.KD.Nr.5-5/2022 të datës 22.04.2022, është bërë shkelje e dispozitave materiale të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësinë e avokatit.

E paraqitura av \_\_\_\_\_ nga Prishtina, me vendimin e kundërshtuar gabimisht është shpallur përgjegjëse për shkelje të rënde të detyrave të parashikuar në nenin 118 par. 1 pika 1.3 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 5, 6, 37 dhe 38 të Kodit të Etikës Profesionale për avokat.

Në kreun XI të Statutit të OAK-së është rregulluar përgjegjësia disiplinore e avokatëve dhe praktikantëve. Bazuar në dispozitën nga neni 117 të këtij statuti, dispozitat në fjalë vijnë në shprehje dhe zbatohen vetëm në rastet kur avokati apo praktikanti merr pjesë në një procedurë gjyqësore në cilësinë e të autorizuarit, mbrojtësit apo përfaqësuesit të ndonjërit nga palët në një procedurë gjyqësore. Aq më tepër, me nenin 118 par. 1 pika 3 të Statutit të OAK-së, si shkelje e rëndë e detyrave dhe autoritetit të avokatisë është parashikuar: “nëse e ushtron punën e avokatit në mënyrë të pandërgjegjshme”, që nënkupton vetëm në rastet kur merr pjesë dhe vepron në cilësinë e avokatit.

E njëjta gjë vlen edhe për dispozitat nga neni 5, 6, 37 dhe 38 të Kodit të Etikës Profesionale të avokatëve. Me këto dispozita është rregulluar qëndrimi i avokatit ndaj palëve në procedurë dhe paraqitja e tij në parashikues dhe veprime tjera zyrtare, që nënkupton kur merr pjesë në procedurë si përfaqësues i autorizuar apo mbrojtës në procedurë gjyqësore. Njëherësh, (neni 37) në rastet kur është i angazhuar në këtë cilësi, “... ka për detyrë të ruaj autoritetin e gjykatave, në të cilat jep ndihëm juridike dhe të ruaj respektin e duhur ndaj tyre . . .”, apo (neni 38) “ avokati në raport me gjykatën dhe institucionet tjera, nuk duhet të jap deklarata fyese apo mendime nënçmuese mbi vendimet e tyre”. Në të gjitha rastet fjala është për rastet kur avokati merr pjesë në një procedurë në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar apo mbrojtësit të një pale, e jo edhe për rastet kur avokati është palë ndërgjyqëse si në rastin konkret.

Në çështjen kontestimore sipas së cilës zhvillohet procedura kontestimore në Gjykatën Themelore të Prishtinës, me shenja të shkresave C. nr. 3611/17, në të cilën procedurë edhe, nga av. Merita Bajraktari, është dorëzuar përgjigja në ankesë ku janë përdorë shprehjet për të cilat ajo është shpallur përgjegjëse, e përmendura av. ka qenë dhe këtë përgjigje në ankesë e ka dorëzuar në cilësinë e paditëses e jo si e autorizuar e ndonjërës nga palët që kanë marr pjesë në këtë procedurë. Përgjegjësia e palëve në procedurë gjyqësore, në çështjet kontestimore është rregulluar me dispozitat nga neni 288 përfundimisht me nenin 295 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Në këtë mënyrë, nëse gjykata ka konsideruar se e paraqitura av. Merita Bajraktari, në cilësinë e palës paditëse e ka keqpërdor të drejtat e veta ose e ka fyer gjykatën, ka mundur ndaj saj të ndërmer masat e nevojshme të parashikuara në nenet 288 dhe 289 të LPK-së, pasi që avokati i cili merr pjesë në procedurën kontestimore në cilësinë e palës ndërgjyqës në procedurë nuk mund të merret në përgjegjësi disiplinore pranë OAK-së.

Nga kjo arsye për veprimet e ndërmarra në cilësi të palës paditëse e jo si e autorizuar e ndonjërës nga palët, av. nuk mund të mban përgjegjësi disiplinore pranë OAK-së.

Nga arsyet e cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS  
PRISHTINË V.KA.nr. V.KA.nr.6-4/2020 dt. 07.06.2022

Kryetari i kolegjit

Avokat, Ruzhdi Berisha

